



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1625/1 Prot

Tiranë, më 03.12.2019

V E N D I M

Nr.150, datë 03.12.2019

“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Klos në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil, të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, të Komisionerit”.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit në lidhje me verifikimin e kryer në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Klos,

VËREJ SE,

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me emërimet në shërbimin civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit, me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019 “Për fillimin e procesit të inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil”, ka nisur kryesisht procesin e verifikimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku përfshihet edhe Bashkia Klos.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në subjekt nga grupi i inspektimit, i autorizuar nga Komisioneri për këtë qëllim. Nga aktet e administruara gjatë inspektimit në subjekt, ka rezultuar se, Bashkia Klos, është e organizuar dhe funksionon në bazë të strukturës dhe organikës të miratuar me vendimin nr. 122, dt. 20.12.2018, të Këshillit të Bashkisë Klos “Për miratimin e buxhetit dhe numrit të punonjësve të bashkisë Klos”, si dhe urdhrin nr. 14/3, datë 01.07.2019, të Kryetarit të Bashkisë “Për miratimin e strukturës organizative të ndryshuar të Bashkisë Klos”, strukturë e cila ishte në fuqi edhe në momentin e kryerjes së verifikimit.

Sipas strukturës, Bashkia Klos së bashku me njësitë administrative në përbërje të saj, ka gjithsej **45** pozicione pune të vlerësuara si pjesë e shërbimit civil, të cilat sipas kategorive të shërbimit civil klasifikohen: **3** pozicione të kategorisë së mesme drejtuese, **11** pozicione të kategorisë së ulët drejtuese dhe **31** pozicione të kategorisë ekzekutive.

Gjatë procesit të verifikimit në subjekt, u konstatua se, **12** pozicione pune të shërbimit civil, janë plotësuar në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij; **32** pozicione të shërbimit civil, rezultojnë aktualisht janë plotësuar me punonjës të punësuar me akt emërimi apo kontrata të përkohshme dhe jo sipas një procedure konkurrimi të hapur, e cila është e vetmja mënyrë për të plotësuar pozicionet e punës të kategorisë ekzekutive, apo nëpërmjet lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, për pozicionet e nivelit drejtues; ndërsa **1** pozicioni i shërbimit civil rezulton i lirë.

Konkretisht, rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin evidentohen si më poshtë, ku specifikohet punonjësi që kryen aktualisht detyrën, pozicioni i punës, si edhe akti i emërimit i nxjerrë nga titullari i institucionit:

1. *****, “Specialist i Shërbimeve dhe Kontroll Territori”, emëruar me aktin nr.35, datë 23/06/2016.
2. *****, “Specialist Bujqësie për Njësinë Administrative Gurrë dhe Suç”, emëruar me aktin nr.13, datë 01/02/2018.
3. *****, “Përgjegjës i Emergjencave Civile”, emëruar me aktin nr. 57, datë 01/09/2016.
4. *****, “Përgjegjës i Sektorit të Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit”, emëruar me aktin nr. 59, datë 01/09/2016.
5. *****, “Specialist Shërbimesh dhe Kontroll Territori”, emëruar me kontratë pune datë 16/10/2015.
6. *****, “Përgjegjës Auditi i Brendshëm”, emëruar me aktin nr. 37, datë 17/05/2017.
7. *****, “Përgjegjës i Sektorit të Urbanistikës”, emëruar me aktin nr. 4, datë 18/01/2019.

8. *****, “Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve”, emëruar me aktin nr. 11, datë 01/02/2018.
9. *****, “Specialiste Urbanistike”, emëruar me aktin nr. 116, datë 11/12/2018.
10. *****, “Specialiste Urbanistike”, emëruar me aktin nr. 22, datë 11/02/2019.
11. *****, “Specialiste e Kontrollit të Ushqimit”, emëruar me aktin nr. 10, datë 01/02/2019.
12. *****, “Specialiste Urbanistike”, emëruar me aktin nr. 113, datë 03/12/2018.
13. *****, “Specialist Shërbimesh”, emëruar me aktin nr. 32, datë 01/02/2018.
14. *****, “Specialist IT dhe Koordinator për njoftimin dhe Konsultimin Publik”, emëruar me aktin nr. 11, datë 1/2/2019.
15. *****, “Specialiste e kadastrës dhe GIS”, emëruar me aktin nr. 13, datë 09/03/2017.
16. *****, “Specialist Tatim Taksave”, emëruar me aktin nr. 48, datë 09/06/2017.
17. *****, “Specialiste e të Ardhurave Lokale”, emëruar me aktin nr. 112, datë 03/12/2018.
18. *****, “Inspektor i të Ardhurave Lokale”, emëruar me aktin nr. 27, datë 20/3/2019.
19. *****, “Specialiste e Ndhmës Ekonomike, Njësia Administrative Xibër”, emëruar me aktin nr. 68, datë 30/04/2018.
20. *****, “Inspektor i Çështjeve Sociale”, emëruar me aktin nr. 4/1, datë 11/3/2013.
21. *****, “Përgjegjës i Sektorit të të Ardhurave Lokale”, emëruar me aktin nr. 10, datë 01/02/2018.
22. *****, “Specialist i Ndhmës Ekonomike, Njësia Administrative Xibër”, emëruar me aktin nr.65, datë 16/04/2018.
23. *****, “Specialist i Ndhmës Ekonomike, Njësia Administrative Suç”, emëruar me aktin nr. 41, datë 24/05/2017.
24. *****, “Specialist i Ndhmës Ekonomike, Njësia Administrative Gurrë”, emëruar me aktin nr.02, datë 03/01/2019.
25. *****, “Specialist Shërbimesh”, emëruar me aktin nr. 8/1, datë 14/08/2015.
26. *****, “Specialist i Tatim Taksave dhe Arkivi i Njësia Administrative Xibër”, emëruar me aktin nr. 21/1, datë 1/03/2016.
27. *****, “Specialist i Ndhmës Ekonomike, Njësia Administrative Gurrë”, emëruar me aktin nr. 8/1, datë 14/08/2015.
28. *****, “Specialist Shërbimesh”, emëruar me aktin nr. 8/1, datë 14/08/2015.

29. *****, “Përgjegjës Sektori Shërbimit Pyjor”, emëruar me aktin nr. 99, datë 11/09/2018.
30. *****, “Inspektor Pyjesh”, emëruar me aktin nr. 24, datë 01/3/2019.
31. *****, “Inspektor Pyjesh”, emëruar me aktin nr. 73, datë 31/5/2018.
32. *****, “Inspektor Pyjesh”, emëruar me aktin nr. 28, datë 01/02/2018.

Komisioneri konstaton se, aktet e emërimit të evidentuara më sipër, kanë dalë në kundërshtim me ligjin, pasi, për çdo marrëdhënie të re pune, që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në bazë të nenit 22, 23, 25 dhe 26 të tij, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt konkurrimit. Çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm.

Vërejmë se, duke vepruar në këtë mënyrë, titullari i institucionit, ka vepruar në kundërshtim me procedurën e nxjerrjes së aktit, referuar parashikimeve të legjislacionit në fuqi, ç’ka në vështirësi të nenit 108, pikat i) dhe ii) të shkronjës “a” dhe shkronjës “ç”, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, i bën aktet absolutisht të pavlefshëm.

Për më tepër, ndalimi i emërimit në kundërshtim me procedurën, është theksuar shprehimisht në pikën 4, të nenit 23, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, për të mos lejuar subjektivitet apo keqinterpretime në implementimin e kësaj dispozite në praktikë.

Në vijim të këtij arsytimi, në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, veprimi administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë.

Nisur nga detyrimi i parashikuar nga neni 111, i ligjit në fjalë, vetë organi publik, në këtë rast Kryetari i Bashkisë Klos, duhet të konstatojë në këto veprime administrative, ekzistencën e rasteve të parashikuara në nenin 108, të ligjit si më lart, dhe në bazë të pikës 1, të nenit 113, të po këtij ligji, të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të këtyre akteve dhe të rregullojë pasojat duke ndërprerë marrëdhënien e punës të lidhur në kundërshtim me procedurat ligjore dhe më tej, duke i shpallur si të lira këto pozicione, për t’u plotësuar në përputhje me ligjin për nëpunësin civil.

Pozicionet në fjalë, duhet të plotësohen me anën e procedurave të konkurrimit të hapur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij, apo nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë.

Njësia përgjegjëse, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, duhet të kujdeset të përmbushë rregullat e përcaktuara në kreun IV “Pranimi në shërbim civil”, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të

Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhe vendimin nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, si dhe udhëzimin nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Klos, me synim rregullimin e situatës së ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, të konstatojë menjëherë, si akte administrative absolutisht të pavlefshëm, **32** rastet e emërimit të punonjësve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil dhe të rreullojë pasojat për punonjësit:
 - ***** , “Specialist i Shërbimeve dhe Kontroll Territori”, emëruar me aktin nr.35, datë 23/06/2016.
 - ***** , “Specialist Bujqësie për Njësinë Administrative Gurrë dhe Suç”, emëruar me aktin nr.13, datë 01/02/2018.
 - ***** , “Përgjegjës i Emergjencave Civile”, emëruar me aktin nr. 57, datë 01/09/2016.
 - ***** , “Përgjegjës i Sektorit të Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit”, emëruar me aktin nr. 59, datë 01/09/2016.
 - ***** , “Specialist Shërbimesh dhe Kontroll Territori”, emëruar me kontratë pune datë 16/10/2015.
 - ***** , “Përgjegjës Auditi i Brendshëm”, emëruar me aktin nr. 37, datë 17/05/2017.
 - ***** , “Përgjegjës i Sektorit të Urbanistikës”, emëruar me aktin nr. 4, datë 18/01/2019.
 - ***** , “Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve”, emëruar me aktin nr. 11, datë 01/02/2018.
 - ***** , “Specialiste Urbanistike”, emëruar me aktin nr. 116, datë 11/12/2018.

- ***** , “*Specialiste Urbanistike*”, emëruar me aktin nr. 22, datë 11/02/2019.
- ***** , “*Specialiste e Kontrollit të Ushqimit*”, emëruar me aktin nr. 10, datë 01/02/2019.
- ***** , “*Specialiste Urbanistike*”, emëruar me aktin nr. 113, datë 03/12/2018.
- ***** , “*Specialist Shërbimesh*”, emëruar me aktin nr. 32, datë 01/02/2018.
- ***** , “*Specialist IT dhe Koordinator për njoftimin dhe Konsultimin Publik*”, emëruar me aktin nr. 11, datë 1/2/2019.
- ***** , “*Specialiste e kadastrës dhe GIS*”, emëruar me aktin nr. 13, datë 09/03/2017.
- ***** , “*Specialist Tatim Taksave*”, emëruar me aktin nr. 48, datë 09/06/2017.
- ***** , “*Specialiste e të Ardhurave Lokale*”, emëruar me aktin nr. 112, datë 03/12/2018.
- ***** , “*Inspektor i të Ardhurave Lokale*”, emëruar me aktin nr. 27, datë 20/3/2019.
- ***** , “*Specialiste e Ndhmës Ekonomike, Njësia Administrative Xibër*”, emëruar me aktin nr. 68, datë 30/04/2018.
- ***** , “*Inspektor i Çështjeve Sociale*”, emëruar me aktin nr. 4/1, datë 11/3/2013.
- ***** , “*Përgjegjës i Sektorit të të Ardhurave Lokale*”, emëruar me aktin nr. 10, datë 01/02/2018.
- ***** , “*Specialist i Ndhmës Ekonomike, Njësia Administrative Xibër*”, emëruar me aktin nr.65, datë 16/04/2018.
- ***** , “*Specialist i Ndhmës Ekonomike, Njësia Administrative Suç*”, emëruar me aktin nr. 41, datë 24/05/2017.
- ***** , “*Specialist i Ndhmës Ekonomike, Njësia Administrative Gurrë*”, emëruar me aktin nr.02, datë 03/01/2019.
- ***** , “*Specialist Shërbimesh*”, emëruar me aktin nr. 8/1, datë 14/08/2015.
- ***** , “*Specialist i Tatim Taksave dhe Arkivi i Njësia Administrative Xibër*”, emëruar me aktin nr. 21/1, datë 1/03/2016.
- ***** , “*Specialist i Ndhmës Ekonomike, Njësia Administrative Gurrë*”, emëruar me aktin nr. 8/1, datë 14/08/2015.
- ***** , “*Specialist Shërbimesh*”, emëruar me aktin nr. 8/1, datë 14/08/2015.
- ***** , “*Përgjegjës Sektori Shërbimit Pyjor*”, emëruar me aktin nr. 99, datë 11/09/2018.
- ***** , “*Inspektor Pyjesh*”, emëruar me aktin nr. 24, datë 01/3/2019.
- ***** , “*Inspektor Pyjesh*”, emëruar me aktin nr. 73, datë 31/5/2018.
- ***** , “*Inspektor Pyjesh*”, emëruar me aktin nr. 28, datë 01/02/2018.

2. Njësia përgjegjëse, të shpallë menjëherë për t’u plotësuar pozicionet e shërbimit civil që, në kuptim të ligjit, janë vende vakante, si dhe ato të plotësuar në kundërshtim me ligjin dhe më tej, të vijojë realizimi i procedurave të konkurrimit sipas strukturës

aktuale dhe nevojave që do të ketë institucioni në momentin e ekzekutimit të vendimit.

3. Institucioni të përgatitë dhe të miratojë planin e nevojave për rekrutimin në shërbimin civil për vitin e ardhshëm, për pozicionet e mbetura vakant deri në shkurt të vitit 2020, duke respektuar procedurat dhe afatet e përcaktuara në vendimin nr. 108, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”.
4. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **3 (tre) muaj** nga marrja dijani për këtë vendim. Institucioni i inspektuar dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim, duke u bazuar në orientimet e dhëna në pjesën arsyetuese të tij.

Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, njësia e vetëqeverisjes vendore Bashkia Klos, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.

5. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjositjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
6. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Klos, Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Klos, Ministria e Brendshme, Prefekti i Qarkut Dibër, si dhe çdo punonjës që është i emëruar në kundërshtim me ligjin dhe që është i evidentuar në këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha